

***Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k***

***Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2023***

## Përmbajtja:

<i>Pasqyra e Pozicionit Financiar</i> .....	2
<i>Pasqyra e Performancës</i> .....	3
<i>Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto</i> .....	4
<i>Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare</i> .....	5
1. Informacion i përgjithshëm .....	6
2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave.....	6
2.1 Bazat e përgatitjes .....	6
2.2 Bazat e matjes .....	6
2.3 Periudhat krahasimore .....	6
2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes.....	6
2.5 Vlerësime dhe gjykime .....	6
3. Politikat kontabël .....	7
3.1 Transaksionet në monedhë të huaj .....	7
3.2 Instrumenta financiare .....	7
3.3 Aktive afatgjata materiale .....	8
3.4 Zhvlerësimi .....	9
3.5 Provigjonet.....	9
3.6 Njohja e të ardhurave .....	9
3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare .....	10
3.8 Tatimi mbi fitimin.....	10
4. Mjete monetare .....	10
5. Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit .....	10
6. Aktivet afatgjata materiale .....	11
7. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit .....	11
8. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe Sigurime shoqërore dhe shëndetësore .....	11
9. Të pagueshme për detyrimet tatimore.....	11
10. Të tjera të pagueshme .....	12
11. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit.....	12
12. Shpenzime personeli .....	12
13. Shpenzime amortizimi .....	12
14. Të tjera shpenzime .....	12
15. Shpenzime financiare neto.....	13
16. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin.....	13
17. Ngjarje pas datës së raportimit.....	13

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**

AKTIVET	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
<b>Mjetet monetare:</b>	4	6,166,016	3,699,177
Banka		6,166,016	3,699,177
<b>Të drejta të arkëtueshme:</b>		4,314,188	2,358,922
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	5	4,308,188	2,358,922
Të tjera		6,000	-
<b>Aktive totale afatshkurtra</b>		<b>10,480,203</b>	<b>6,058,100</b>
<b>Aktivet materiale:</b>			
<b>Makina</b>	6	193,284	-
<b>Aktive totale afatgjata</b>		<b>193,284</b>	<b>-</b>
<b>AKTIVE TOTALE</b>		<b>10,673,487</b>	<b>6,058,100</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	7	61,885	440,535
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore	8	215,031	208,094
Të pagueshme për detyrimet tatimore	9	300,772	385,308
Të tjera të pagueshme	10	16,620	8,045
<b>Totali i Detyrimeve Afatshkurtra</b>		<b>594,308</b>	<b>1,041,981</b>
<b>Detyrimet afatgjata:</b>		-	-
<b>Totali i Detyrimeve afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Detyrimet totale</b>		<b>594,308</b>	<b>1,041,981</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
<b>Kapitali i Nënshkruar</b>		100	100
<b>Rezerva të tjera:</b>		1,044,000	520,000
Rezerva ligjore		1,044,000	520,000
<b>Fitimi i pashpërndarë</b>		-	523,996
<b>Fitim/Humbja e vitit</b>		9,035,079	3,972,022
<b>Totali i Kapitalit</b>		<b>10,079,179</b>	<b>5,016,118</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>10,673,487</b>	<b>6,058,099</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 13 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Pasqyra e Performancës deri më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

**Pasqyra e Performancës**

	<i>Shënime</i>	<i>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</i>	<i>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</i>
<i>Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	11	13,799,928	8,252,883
<i>Shpenzime të personelit:</i>	12	2,559,561	2,687,395
<i>Paga dhe shpërblime</i>		2,202,000	2,310,636
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)</i>		357,561	376,759
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	13	21,476	-
<i>Shpenzime të tjera shfrytëzimi</i>	14	1,630,190	1,448,627
<i>Shpenzime financiare:</i>	15	(553,622)	(144,839)
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)</i>		496	293
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		(554,118)	(145,132)
<i>Fitim/humbja para tatimit</i>		9,035,079	3,972,022
<i>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin:</i>	16	-	-
<i>Shpenzimi i tatim fitimit të periudhës</i>		-	-
<b><i>Fitimi/Humbja e vitit</i></b>		<b>9,035,079</b>	<b>3,972,022</b>

*Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6-13 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e pashpërndara	Fitim/Humbja e vitit	Total
<b>Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2021</b>			4,944,185		4,944,185
Efekti i ndryshimeve në politikat konatabel					
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2022</b>			4,944,185		4,944,185
Fitim/Humbja e vitit				3,972,022	3,972,022
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>			(4,420,189)	3,972,022	3,972,022
Dividend të paguar					(4,420,189)
Rezervë ligjore		520,000			520,000
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	100	520,000			520,000
<b>Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2022</b>	100	520,000	523,996		5,016,118
Efektet e ndryshimeve në politikat konatabel					
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2023</b>	100	520,000	523,996		5,016,118
Fitim/Humbja e vitit				3,972,022	3,972,022
<b>Fitim/Humbje të pashpërndara</b>			523,996		5,016,118
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse				9,035,079	9,035,079
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin:</b>				9,035,079	9,035,079
Emetimi i kapitalit të nënshkruar					
Dividentë të paguar					
Rezervë ligjore		524,000	(523,996)	(3,972,022)	(3,972,022)
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike		524,000	(523,996)	(3,972,022)	(3,972,018)
<b>Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2023</b>	100	1,044,000		9,035,079	10,079,179

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6-13 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 u aprovuan nga administratori dhe u nënshkruan si më poshtë:

Administrator

Ermir Bekaj



Hartues i pasqyrave financiare

Rady M. Hoxha

Kazeti Consulting



**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**

Metoda Indirekte

Shënime	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</b>		
Fitim/Humbja e vitit	9,035,079	3,972,022
<b>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</b>	<b>21,476</b>	<b>-</b>
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	21,476	
<b>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</b>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(2,720,696)	1,454,541
Rënie/(rritje) në detyrimet e pagueshme	(1,955,265)	462,960
Rënie/(rritje) në detyrimet për punonjësit	(696,408)	439,975
Rënie/(rritje) në detyrimet tatimore	6,937	208,094
Rënie/(rritje) në detyrimet e tjera	(84,535)	335,468
Rënie/(rritje) në detyrimet e tjera	8,575	8,045
<b>Mjete monetare neto nga/përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(2,699,220)</b>	<b>1,454,541</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/përdorur në aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(214,760)	
<b>Mjete monetare neto nga/përdorur në aktivitetin e investimit</b>	<b>(214,760)</b>	<b>-</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/përdorur në aktivitetin e financimit</b>		
Pagesa për dividendët	(3,654,260)	(8,208,934)
Kapitali i nënshkruar i papaguar		100
<b>Mjete monetare neto nga/përdorur në aktivitetin e financimit</b>	<b>(3,654,260)</b>	<b>(8,208,834)</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>2,466,839</b>	<b>(2,782,271)</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar</b>	<b>3,699,177</b>	<b>6,481,448</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>4 6,166,016</b>	<b>3,699,177</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6–13 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Shënimet Shpjeguese më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

---

**1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria Zyra Ligjore Rakipi & Partners shpk (më poshtë referuar si "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 08 Korrik 2020 dhe pranë Degës së Tatimeve dhe Taksave Tiranë me NIPT M01908027N.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve të ndryshme në fushën juridike.

Administrator i Shoqërisë është Z. Ermir Beta.

Selia kryesore e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Ibrahim Rugova, pallatet Green Park Tower, Kulla Nr.1, Kati Nr.11, Ap Nr.54.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2023 është 4 (katër).

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave**

**2.1 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare të "Zyra Ligjore Rakipi & Partners" Sh.p.k janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me ato standarde dhe interpretime të cilat kanë qenë efektive për periudhën me të cilën këto pasqyra financiare kanë të bëjnë.

**2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

**2.3 Periudhat krahasimore**

Për vitin ushtrimor 2023 kompania ka periudha të mëparshme krahasimore dhe informacionet e paraqitura janë në krahasim me vitin ushtrimor paraardhës, vitin 2022.

**2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**2.5 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjës gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Shënimet Shpjeguese më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

---

### **3. Politikat kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

#### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e asetëve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj janë:

**31/12/2023**

Euro/Lek	103.88
Usd/Lek	93.94

#### **3.2 Instrumenta financiare**

Instrumentat financiare joderivative përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiare joderivative maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pambajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Paraja dhe ekuivalentet e parasë*

Paraja dhe ekuivalentet e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat dhe depozita me një afat maturimi prej tremujsh ose më pak që nga data fillestare.



**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Shënimet Shpjeguese më 31 Dhjetor 2023**

*(shumat në Lek)*

---

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme (kërkesat e arkëtueshme) njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose pagesa të vonuara konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis vlerës fillestare dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamartjes duke u bazuar në metodën e interesit efektiv.

*Të tjera*

Instrumenta të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### **3.3 Aktive afatgjata materiale**

*Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në menyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

*Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet mbi koston e blerjes së aktivitetit të zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në menyrë zbritëse përgjatë jetës së aktivitetit.

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Shënimet Shpjeguese më 31 Dhjetor 2023**

*(shumat në Lek)*

---

### **3.4 Zhvlerësimi**

#### *Aktivët financiarë*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiarë vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar të disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### *Aktivët jofinanciarë*

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciarë të Shoqërisë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### **3.5 Provigjonet**

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kur shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij, ose kur vlera të caktuara të të drejtave pritet të mosarkëtohen plotësisht në të ardhmen.

Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin/të drejtën në fjalë.

### **3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë që rezultojnë në rritje të kapitalit neto gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit neto në sajë të kontributeve të ortakëve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet, nëse ka.

Shoqëria kryen shërbime siç është parashikuar në statut. Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Shënimet Shpjeguese më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zërat e njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

## 4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Mjete monetare në bankë	6,166,016	3,699,179
Në lekë	2,653,315	1,213,604
Në monedhë të huaj	3,512,701	2,485,575
	<b>6,166,016</b>	<b>3,699,179</b>

## 5. Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Llogaritë e arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Klientë për shërbime	4,308,188	2,358,922
	<b>4,308,188</b>	<b>2,358,922</b>

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Shënimet Shpjeguese më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

**6. Aktivet afatgjata materiale**

Aktivët afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	Mjete transporti	Totali
<i>Kosto</i>		
Gjendja më 1 janar 2022	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	-	-
Shtesa	214,760	214,760
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>214,760</b>	<b>214,760</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>		
Gjendja më 1 janar 2022	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	-	-
Amortizimi i vitit	21,476	21,476
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>21,476</b>	<b>21,476</b>
<i>Vlera neto kontabël</i>		
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>193,284</b>	<b>193,284</b>

**7. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit**

Llogaritë e pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Llogari të pagueshme tregtare	61,885	440,535
	<b>61,885</b>	<b>440,535</b>

**8. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe Sigurime shoqërore dhe shëndetësore**

Detyrimet ndaj punonjësve dhe Sigurime shoqërore dhe shëndetësore më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Paga të pagueshme	161,776	154,491.00
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe TAP	53,255	53,603.00
	<b>215,031</b>	<b>208,094</b>

**9. Të pagueshme për detyrimet tatimore**

Detyrimet tatimore më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Tatim mbi vlerën e shtuar	228,773	313,309
Tatim në burim	71,999	71,999
	<b>300,772</b>	<b>385,308</b>

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Shënimet Shpjeguese më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

**10. Të tjera të pagueshme**

Llogaritë e tjera të pagueshme më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Të tjera të pagueshme ndaj ortakut/administratorit	16,620	8,045
	<b>16,620</b>	<b>8,045</b>

**11. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	13,799,928	8,252,883
	<b>13,799,928</b>	<b>8,252,883</b>

**12. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>
Shpenzime për paga	2,202,000	2,310,636
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	357,561	376,759
	<b>2,559,561</b>	<b>2,687,395</b>

**13. Shpenzime amortizimi**

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>
Shpenzime amortizimi	21,476	-
	<b>21,476</b>	<b>-</b>

**14. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera administrative për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

**Zyra Ligjore Rakipi & Partners Sh.p.k**  
**Shënimet Shpjeguese më 31 Dhjetor 2023**

(shumat në Lek)

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>
Shpenzime qeraje	960,000	960,000
Taksa vendore	138,420	15,500
Shërbime konsulence	42,978	93,282
Shpenzime të tjera	488,792	379,845
	<b>1,630,190</b>	<b>1,448,627</b>

**15. Shpenzime financiare neto**

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>
Komisone bankare	(15,369)	(18,090)
Humbje nga këmbimet valutore	(551,259)	(161,898)
Të ardhura nga këmbimet valutore	12,510	34,856
Të ardhurat nga interesat	496	293
	<b>(553,622)</b>	<b>(144,839)</b>

**16. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin më 31 Dhjetor 2023 është si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	9,035,079
Total shpenzime të panjohura	296,951
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	23,791
Shpenzime të tjera	273,160
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>9,332,030</b>
Humbje fiskale e mbartur	-
<b>Tatim fitimi</b>	-
<b>Fitimi neto</b>	<b>9,332,030</b>

Shoqëria llogarit tatimin mbi fitimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, sipas të cilit norma e tatimit mbi fitimin është 0% (2022: 0%).

**17. Ngjarje pas datës së raportimit.**

Shoqëria nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që ndikojnë në informacionin e këtyre pasqyrave financiare.